



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Hyrje në Letërsi 1

Ngarkesa: 6 kredite, 15 leksione, 45 seminare.
Viti / Semestri : Viti I, semestri I.
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme.
Programi i studimit: Bachelor, Gjuhë angleze.
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore : Njohje me teorinë letrare: Të pajisë studentët me njohuri bazë për gjinitë letrare, veçanërisht për prozën artistike dhe nënlojet e saj (tregimi, novela, romani etj.). Formim analitik: Të zhvillojë aftësinë e studentëve për të analizuar dhe interpretuar veprat letrare në mënyrë të argumentuar dhe të strukturuar. Kultivim estetik dhe gjuhësor: Të rrisë ndjeshmërinë estetike dhe të përmirësojë nivelin gjuhësor të studentëve përmes analizës së teksteve letrare në anglisht.

Objektivat specifike lëndorë:

1. Zotërimi i koncepteve themelore: Të njohin termat dhe konceptet kyçe që përdoren në analizën e prozës, si struktura narrative, personazhi, narratori, tematika etj.
2. Zbatimi praktik i analizës: Të jenë në gjendje të realizojnë analizë estetike dhe stilistike të tregimeve dhe novelave të zgjedhura në gjuhën angleze.
3. Njohje me autorë anglofonë: Të fitojnë njohuri mbi disa nga prozatorët më përfaqësues të letërsisë amerikane dhe angleze, përmes leximit dhe diskutimit të veprave të tyre.

Rezultatet e pritshme:

1. Të jenë të aftë gjithashtu në gjendje të lexojnë nga afër tregime e novela e të analizojnë ato duke pasur parasysh gjithë elementet letrare si: struktura, rrëfimi, personazhet, simbolet, etj.
2. Të jenë të aftë gjithashtu të aftë të bëjnë interpretime shkrimesh në prozë nga këndvështrime të ndryshme teorish letrare si strukturalizmi, feminizmi, analiza psikologjike, etj.